



- [Të Reja](#) [Policia e Shtetit](#) [Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet e policisë](#) [Video](#)
- [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#) [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore të Policisë](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#)
- [Donacione](#) [Rubrika Policimi në Komunitet](#) [Përmbledhja Javore](#) [Për sinjalizimin](#)

Breaking News: [Tiranë – Finalizohet faza e tretë e operacionit policor të koduar “Transportuesi”](#)
[Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Last guide”](#)

[Raporti i ngjarjeve, 20 dhjetor 2023](#)
[Fier – U kapën në flagrancë, në tentativë për të vjedhur në një biznes, arrestohen 2 vëllezër](#)
[DVP Lezhë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Ethanol”](#)



21/12/2023

Tiranë – Finalizohet Faza E Tretë E Operacionit Poljcor Të Koduar “Transportuesi”

Tiranë/Vijon operacioni policor i koduar “Sundimi i ligjit”.

Në kuadër të këtij operacioni, nga Seksioni për Hetimin e Trafiqueve të Paligjshme në DVP Tiranë, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, është finalizuar faza e tretë e operacionit policor të koduar “Transportuesi”.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë, së bashku me krëhrin e municion luftarak.

I dënuar më parë për armëmbajtje pa leje, kapet dhe vihet në pranga 42-vjeçari.

Më parë, në kuadër të operacionit “Transportuesi”, janë vënë në pranga dy shtetas dhe janë sekuestruar 4 armë zjarri pistoletë, krëhra e municion luftarak, një silenciator, dy automjete e aparate celulare.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqueve të Paligjshme në DVP Tiranë, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, pas një punë intensive hetimore, kanë vijuar operacionin policor të koduar “Transportuesi”, dhe kanë goditur një tjetër rast të mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, me qëllim shitjen e tyre.

Si rezultat, në Rrugën e Kavajës u kap dhe u arrestua shtetasi M. H., 42 vjeç, banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit fizik të tij, shërbimet e Policisë i gjetën një armë zjarri pistoletë, me krëhër e municion luftarak, të cilat u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale.

Nga verifikimet e kryera dyshohet se 42-vjeçari i arrestuar, ka siguruar armën e zjarrit, me qëllimin shitjen e saj, te persona të tjerë.

Operacioni “Transportuesi” vijon.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ [Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Last guide”](#)